



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDARYSHE

Njoftim për zgjatje të Thirrjes për ofertë

Organizimi i trajnimeve dhe hartimi i dokumenteve në kuadër të projekti “Treguesit e rinjë të trashëgimisë së Istogut”

EC Ma Ndryshe njofton se ka bërë zgjatjen e afatit të pranimit të ofertave për organizimin e trajnimeve dhe hartimin e dokumenteve në kuadër të projektit “Treguesit e rinjë të trashëgimisë së Istogut” deri më 18 mars 2020 në ora 15:00.

Projekti “Treguesit e rinjë të trashëgimisë së Istogut” synon të kontribuojë në përmirësimin e njohurive të rinjëve dhe pjesëmarrjen e tyre në mbrojtjen dhe promovimin e kulturës dhe trashëgimisë së Istogut. Grupi kryesor i synuar i projektit janë fëmijët e shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Istogut. Ky projekt mundësohet nga Programi Rajonal mbi Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD dhe financohet nga Bashkimi Evropian, me bashkë-financim nga Komuna e Istogut, dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

EC Ma Ndryshe fton kompanitë/konsorciumet, OJQ-të, grupet e ekspertëve të interesuar të dorëzojnë ofertat e tyre për angazhimet e mëposhtme:

1. Organizimi i trajnimit të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme për trashëgiminë kulturore dhe natyrore (rreth 30 pjesëmarrës)

Trajnimi do të mbahet në Istog dhe duhet të përmbajë këto tri module: 1. trashëgimia kulturore dhe natyrore; 2. tregimi i historisë dhe interpretimi mbi trashëgiminë dhe 3. punën e ciceronit si interpretues i një vendi. Trajnimi duhet të jetë praktik dhe i dizajnuar enkas për grupmoshat e përfshira. Çdo modul i trajnimit duhet të zgjasë dy ditë dhe pjesëmarrësit do të pajisen me certifikata pjesëmarrjeje pas përfundimit të suksesshëm të të gjithë programit (të tre moduleve). Pjesëmarrës do të jenë nxënësit e përzgjedhur fitues në garën për tregimin më të mirë dhe gjatë këtyre moduleve ata do të ndihmohen që të përmirësojnë tregimet e tyre (së paku 40 tregime) të cilat do të publikohen në ‘Librin e trashëgimisë’ shpërguar më poshtë.

2. Hartimi i ‘Librit të trashëgimisë: trashëgimia siç shihet dhe interpretohet nga nxënësit’

Libri i trashëgimisë duhet të përmbajë së paku 40 tregime të nxënësve (1 faqe A4 për tregim) për monumente të trashëgimisë kulturore, fetare, natyrore, zeje të vjetër, festival, traditë apo karakteristikë tjetër të komunës së Istogut. Eksperti/ja duhet të ndihmojë nxënësit në

përgatitjen e tregimeve, redaktimin e tyre dhe finalizimin e librit. Libri duhet të shërbejë si material informues mbi trashëgiminë kulturore dhe historike të Istogut sipas vështrimit dhe interpretimit nga nxënësit dhe si i tillë do të shpërndahet në shkollat e Istogut dhe promovohet si material për promovimin e turizmit të Istogut.

3. Hartimi i Udhëzuesit për përfshirjen e mësimit praktik të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në kurrikulën shkollore

Udhëzuesi duhet të ofrojë udhëzime praktike për autoritetet lokale dhe ato qendrore, si dhe shkollat, për përfshirjen e mësimit praktik të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në kurrikulën shkollore. Në bashkëpunim të afërt me ekipin e projektit, eksperti/ja duhet të përpilojë dokumentin me fokus në pjesën praktike, krahas asaj teorike, që ofron shembuj dhe modele nga Kosova dhe jashtë saj.

4. Hartimi i strategjisë dy vjeçare për zhvillim të grupit jo formal – Shoqata e të Rinjve për Trashëgimi

Strategjia për Shoqatën e të Rinjve për Trashëgimi ka për qëllim përkrahjen e shoqatës në zhvillimin e saj përmes: propozimit të aktiviteteve dhe hartimit të planit të punës, krijimin e identitetit vizual, promovimin e punës dhe krijimin e kanaleve për promovim përmes rrjeteve sociale (hapjen e llogarive në rrjetet sociale dhe përdorimin efikas të tyre).

Afati për përfundim

1. Organizimi i trajnimit të nxënësve të shkollave fillore dhe te mesme për trashëgiminë kulturore dhe natyrore (rreth 30 pjesëmarrës)	10 Prill 2020
2. Hartimi i 'Librit të trashëgimisë: trashëgimia siç shihet dhe interpretohet nga nxënësit'	30 Prill 2020
3. Hartimi i 'Udhëzuesit për përfshirjen e mësimit praktik të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në kurrikulën shkollore'	15 Maj 2020
4. Hartimi i Strategjisë dy vjeçare për zhvillim të grupit jo formal – Shoqata e të Rinjve për Trashëgimi	30 Maj 2020

Kriteret për ofertim:

- Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim: Çertifikata e regjistrimit të biznesit/ OJQ, Çertifikata e numrit fiskal; Çertifikata e TVSH-së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së), CV-të e personave që do të angazhohen për realizimin e aktiviteteve/produkteve; Për grupet e ekspertëve dërgohen vetëm CV-të e personave përgjegjës;
- Oferta duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtër të metodologjisë për secilin angazhim dhe çmimin përkatës. Çmimi duhet të përfshijë koston profesionale dhe ato të transportit.

- Oferta duhet të përfshijë të gjitha angazhimet;
- Pala ofertuese duhet të caktojë një person për kontakt direkt dhe komunikim me EC Ma Ndryshe;
- Ofertat duhet të dorëzohen fizikisht në zyret e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren dhe në mënyrë elektronike në info@ecmandryshe.org deri më datë 18.03.2020, ora 15:00 me shënim: *Organizimi i trajnimeve dhe hartimi i dokumenteve në kuadër të projektit "Treguesit e rinjë të trashëgimisë së Istogut"*. Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Për pyetje shtesë rreth kësaj thirrjeje mund të na kontaktoni në:
info@ecmandryshe.org deri më datë 18.03.2020.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga kompanitë / OJQ / grupi i ekspertëve, nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Për më shumë informacione rreth kësaj thirrjeje për aplikim, ju lutemi vizitoni www.ecmandryshe.org/konkurse.

5.